

# “Sistemi i pensioneve profesionale private në Shqipëri”

## Metodologjia e studimit

# Qëllimi

Matja e nivelit të njohjes dhe shkalla e njohurive të punëdhënësve dhe punëmarrësve të kompanive private mbi tregun e pensioneve profesionale private në Shqipëri, nëpërmjet metodave statistikore dhe metodologjisë bashkëkohore.

# Përmbledhje

*INSTAT, misioni të cilit është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit, organizoi në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe Bankës Botërore vrojtimit mbi: “Sistemin e Pensioneve Profesionale Private në Shqipëri”*

- Puna e INSTAT konsistoi në hartimin e metodologjisë së vrojtimit, kryerjen e tij, përpunimin statistikor dhe analizën e rezultateve.
- Fazat e punës :
  - Faza përgatitore;
  - Faza e vrojtimit në terren;
  - Faza përmbyllëse;

# Faza e parë: Puna përgatitore

- Njohja me qëllimin e vrojtimit dhe nevojave të përdoruesve për këtë informacion;
  - Ngritja e grupit të punës;
  - Hartimi i planit të aktiviteteve dhe kohëzgjatja e tyre;
  - Përcaktimi i burimeve financiare dhe njerëzore;
- Përcaktimi i njësisë ku do të përqëndrohej vrojtimi
  - Ndërmarrja private e cila kryen aktivitetin e saj brenda territorit të vendit;

## Faza e parë (2)

- Lloji i informacionit
  - Informacion kryesisht cilësor, mbi nivelin e njohurive dhe shkallën e njohjes të sistemit profesional privat të punëdhënësve dhe punëmarrësve të kompanive private;
  - Informacioni u hartua në pyetësor në tre rubrika:
    - Informacion i përgjithshëm mbi ndërmarrjen;
    - Informacion mbi ndërmarrjet që aktualisht nuk kanë plan pensioni profesional privat;
    - Informacion mbi ndërmarrjet të cilët kanë plan pensioni profesional privat;
    - Shënime konkluduese

## Faza e parë (3)

- Përcaktimi i metodave dhe mjeteve:
  - Metoda statistikore :
    - Intervistë të drejtpërdrejtë me pyetsor në letër, me telefon (disa raste) dhe me metodën CAPI (Computer Assisted Personal Interviewing) me tablet, me anë të anketuesve të autorizuar nga INSTAT;
  - Mjete:
    - Rregjistri statistikor i ndërmarrjeve;
    - Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike;

# Faza e dytë: Metodologjia e përdorur

- **Popullata në studim:**
  - Ndërmarrjet me 20 të punësuar e lart;
  - Aktiviteti Ekonomik sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në nivel seksioni nga A në S, përjashtuar seksionin O;
  - Ndërmarrjet me pronësi private jobujqësore.
- **Frame lista me 2130 ndërmarrje;**
- **Në kampion u përzgjodhën 651 ndërmarrje;**
- **Metoda e zgjedhjes është Stratified Systematic Random Sampling (SSRS),**
  - Si variabla stratifikimi shërbyen aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes dhe madhësia e ndërmarrjes sipas numrit të të punësuarve.
  - Metoda e Alokimit –Neyman sipas punësimit.

# Faza e vrojtimit në terren

- Testimi i pyetsorit në letër dhe me tablet;
- Finalizimi i skicimit të pyetsorit si në letër dhe në tablet:
  - Pyetsori në letër I përfunduar;
  - Aplikacioni në tablet me anë të CSPro në versionin 6.0;
- Zgjedhja e stafit mbështetës për kryerjen e vrojtimit në terren:
  - Kontrollor: 1
  - Anketues: 30
- Shpërndarja gjeografike:
  - Në të gjithë territorin e vendit;
- Trajnimi i stafit dhe njohja e tyre me pyetsorin dhe mënyrën e përdorimit të tabletit:
  - Një ditë
- Grumbullimi i të dhënave në terren me metoda të kombinuara:
  - 15 ditë pune
  - Intervistë me pyetsor në letër
  - Intervistë me telefon
  - Intervistë me metodën CAPI me tablet



# Avantazhet e metodës CAPI

- Informacioni i mbledhur ruhet në pajisje dhe transmetohet elektronikisht në faqen e institucionit që bën mbledhjen e të dhënave;
- Cilësi më e mirë e rezultateve të vrojtimit nëpërmjet vendosjes së kushteve logjike dhe të rrugëzimit në pyetësorin në tablet;
- Eleminohet procesi i hedhjes së të dhënave kompjuterike në sistem.
- Transmetimi elektronik i të dhënave mundëson marrjen e të dhënave në kohë reale duke zvogëluar kohën e mbledhjes së të dhënave nga terreni;
- Ulen kostot e printimit pasi printohen vetëm një numër i caktuar pyetësorësh rezervë;



# Faza e tretë: Faza përmbyllëse

- Grumbullimi i pyetësorëve:
  - Pyetsorët letër u dorëzuan në INSTAT, ku u realizua dhe hedhja e tyre në databaze;
  - Transmetimi i të dhënave nga tableti në databaze u krye duke përdorur lidhjen FTP midis tabletëve dhe server-it të INSTAT.
- Kontrolle në terren
  - Për monitorimin e procesit u kryen kontrolle në terren nga stafi i INSTAT, mbi ecurinë e pyetjeve, përdorimin e tabletit, etj;
- Pastrimi i të dhënave
  - Pas krijimit të bazës së të dhënave me të dhëna u krye procesi i pastrimit të gabimeve njerëzore, verifikimit, editimit, etj

## Faza e tretë (2)

- Përgjithësimi i të dhënave
  - Të dhënat u përgjithësuan për popullatën në studim;
  - Procesi i përgjithësimit të të dhënave mori parasysh:
    - Probabilitetin e zgjedhjes së ndërmarrjeve;
    - Kompensimin me të dhëna për ndërmarrjet që:
      - refuzuan që të marrin pjesë në anketë,
      - nuk u kontaktuan ose rezultuan jashtë qëllimit të vrojtimit (të mbyllura dhe të fjetura).

## Shpërndarja e kampionit të ndërmarrjeve sipas qarkut

Qarku	Nr i ndërmarrjeve të anketuara	Nr i ndërmarrjeve të përgjigjur	Refuzime / Pa kontakt	Të mbyllur / Të fjetur
<b>Gjithsej</b>	651	535	97	19
Berat	11	9	1	1
Diber	12	10	1	1
Durrës	75	66	3	6
Elbasan	16	15	1	0
Fier	39	38	0	1
Gjirokastrë	8	7	1	0
Korçë	12	12	0	0
Kukës	2	2	0	0
Lezhë	9	9	0	0
Shkodër	29	29	0	0
Tiranë	422	323	89	10
Vlorë	16	15	1	0

## Faza e tretë (3)

- Përgjithësimi dhe përpunimi i të dhënave.
  - Përfshiu përgjithësimin e të dhënave të ndërmarrjeve në nivelin e “Frame” të përcaktuar, ku nga 2130 ndërmarrje u përgjithësuan rezultatet për 2074 ndërmarrje, (2,63% e ndërmarrjeve rezultuan “mbimbulim”);
  - Kodifikimin e ndërmarrjeve ;
  - U kryen vlerësime të treguesve dhe saktësisë së të dhënave sipas metodave statistikore;
  - Kampioni i zgjedhur llogarit me një saktësi 1,94 % numrin e të punësuarve në ndërmarrje, si dhe një saktësi shumë e mirë të përfaqësimit të tyre (0,71 %).

## Faza e tretë (4)

- Studimi dhe Analiza e të dhënave
  - U krye nëpërmjet softit statistikor SPSS 20;
  - U grupuan variablat kyc, mbi të cilat u ndërtuan të gjitha tabelat përkatëse sipas kërkesave dhe nevojave të përdoruesve për një analizë më të plotë të studimit.
- Përgatitja e raportit përfundimtar.

- Faleminderit për vëmendjen!